



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësi/ Org.
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i Faqeve
Br. Stranica
No. Pages

SP-02
04

Nr. i Prot.
Broj Prot.
Prot. No.
Data:
Date:

1825-2/23
04.05.23

PRISHTINË / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	03.05.2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Helios Power SH.P.K Adresa: Rruga "Luan Haradinaj", Deçan nr. tel.049301060;049301050
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi për refuzimin e kërkesës për Kushtet Ndërtimore për Kategorinë e tretë ndërtimi i projektit "Parku Solar Juniku A&B 100MWp". Komuna e Junikut

I nderuar,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin ndërtimor të dorëzuar për Kushtet Ndërtimore të propozuara nga aplikuesi Helios Power SH.P.K, Deçan –me numër të protokollit 1825/23 të datës 05.04.2023, për projektin "Parku Solar Juniku A&B 100 MWp", Zona kadastrale Junik, Komuna e Junikut, dhe Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banim, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazet Zyrtare, Nr.7,01, Mars, 2019), nenit 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 21 paragrafi 8, nenit 26 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, nenit 17 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Ligjit Nr.04/L-110 Për Ndërtim, si dhe nenit 12 paragrafi 13, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/19 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë së III-të të ndërtimeve, nxjerrë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e Helios Power SH.P.K, Deçan, për miratimin e Kushteve Ndërtimore të propozuara sipas Ekstraktit nga Certifikata e vitit 2021, Komuna e Junikut, Zonale Kadastrale Junik në parcelat kadastrale: 4169-10, 4169-11, 4169-12, 5036-0, 5052-0, 5053-3, 5053-4, 5173-1, 5173-6, 5173-7, 5173-8, të cilat janë kryesisht parcela me shfrytëzim aktual/kultura- klasa kryesisht 2 dhe 3.

Ekstrakti nga Certifikata e vitit 2022, Komuna e Junikut, Zonale Kadastrale Junik në parcelat kadastrale: 4169-10, 4169-11, 4169-12, 5036-0, 5052-0, 5053-3, 5053-4, 5173-1, 5173-6, 5173-7, 5173-8, të cilat janë kryesisht parcela me shfrytëzim aktual/kultura- klasa: Tokë ndërtimore, Infrastrukturë (Rrugë e pakategorizuar) dhe rajon ujor-hendek.

A R S Y E T I M

Aplikuesit për **Kushte Ndërtimore** Helios Power SH.P.K, Deçan, i **Refuzohen Kushtet Ndërtimore të propozuara** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, në bazë të kërkesës me numër protokollit 1825/23 të datës 05.04.2023, drejtuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit

Faqe 2 nga 4


Adresa: ish pallati i mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 200 32 307; +381 38 200 32 245



Hapësinor dhe Infrastrukturës për miratimin e Kushteve Ndërtimore të propozuara për “Parku Solar Juniku A&B 100MWP” – Komuna e Junikut.

Pas shqyrtimit të kërkesës së aplikuesit, themi se dokumentacioni ndërtimor i dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për projektin “Parku Solar Juniku A&B 100MWP” Komuna e Junikut, është në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 8, nenit 26 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, si dhe Planin Hapësinor të Kosovës, Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+, Kapitulli IV - Strategjia dhe Veprimet për Zbatim, 4.1.2.9. Faqe 170 –Harta zhvillimi, mbrojtja dhe ruajtja e resurseve natyrore. Kapitulli i V- Dispozita për zbatim, pika 5.4 Kushtet për caktimin e zonave ndërtimore, si dhe në kundërshtim me dokumentin e planifikimit hapësinor Plani Zhvillimor Komunal 2011-2023 - Komuna e Junikut ku lokacioni ne parcelat e listuara Zona Kadastrale Junik është zonë e destinuar si tokë bujqësore dhe shirita të gjelbër si dhe sipas Hartës 12: Zhvillimet/veprimet e propozuara jashtë zonës urbane,

Harta 12: Zhvillimet/veprimet e propozuara jashtë zonës urbane



Prandaj themi se dokumentacioni ndërtimor i aplikuesit për miratimin e **Kushteve Ndërtimore të propozuara**, është në kundërshtim me legjislacionin dhe me dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi.

Duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe në provat e ofruara u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. **484**

datë: **04.05.2023**

Prishtinë

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Kabinetit të Ministrit,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
4. Komunës së Junikut,
5. Helios Power SH.P.K
6. Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit,
7. Inspektoratit të MMPHI-së,
8. Arkivit të MMPHI-së

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja,
Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planing, Construction and Housing

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Xhemail Metolli, Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, 			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Draft- Përgjigjen për Kushtet Ndërtimore për Kategorinë e tretë ndërtimi i projektit “Parku Solar Juniku A&B 100MWP”. Komuna e Junikut			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1417	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	03.05.2023

I nderuari z. Spahiu ,

Të bashkangjitur gjeni përgjigjen në kërkesën paraprake për Kushtet Ndërtimore për projektet e kategorisë III nga aplikuesi **Helios Power SH.P.K.**, me nr. protokolli 1825/23 të datës 05.04.2023 për ndërtimin e Projektit “Parku Solar Juniku A&B 100MWP” Komuna e Junikut.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, dhe në dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi Planin Hapësinor i Kosovës- Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+ dhe Planit Zhvillimor i Komunës së Junikut 2011-2023 ju bashkëngjet draft-Vendimin për Refuzimin e Kushteve Ndërtimore i cili duhet të shqyrtohet nga Departamenti Ligjor për Procedim të mëtutjeshëm

Me respekt,

Faqe 1 nga 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja,
Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planing, Construction and Housing

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Xhemail Metolli, Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit,			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Draft- Përgjigjen për Kushtet Ndërtimore për Kategorinë e tretë ndërtimi i projektit "Parku Solar Juniku A&B 100MWP" . Komuna e Junikut			
Nr. i zyrës:	1417	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	03.05.2023
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuari z. Metolli,

Të bashkangjitur gjeni përgjigjen në kërkesën paraprake për Kushtet Ndërtimore për projektet e kategorisë III nga aplikuesi **Helios Power SH.P.K.**, me nr. protokolli 1825/23 të datës 05.04.2023 për ndërtimin e Projektit **"Parku Solar Juniku A&B 100MWP"** Komuna e Junikut. Divizioni i Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe duke u bazuar në nenin 21 të **Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor**, dhe në dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi Planin Hapësinor i Kosovës- Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+ dhe Planit Zhvillimor i Komunës së Junikut 2011-2023 ju bashkëngjitet **draft-Vendimin për Refuzimin e Kushteve Ndërtimore** i cili duhet të shqyrtohet nga Departamenti Ligjor për Procedim të mëtutjeshëm

Me respekt,

Faqe 1 nga 1